

Analiza & Komentete

Energjia apo bujqësia? Cilit nga këta dy sektorë duhet t'i jepet përparësi për nga subvencionimi?



Learta Hollaj

Po që se analizojmë përqendrimin e mbështetjes dhe subvencioneve në Kosovë që nga koha e pasluftës vërejmë një fokus të qartë në fushat e energjisë dhe bujqësisë. Përderisa sektori i energjisë subvencionohet intensivisht në pjesën e prodhimit, subvencionet në bujqësi vonuan për një kohë të gjatë. Lëvizjet e para në këtë drejtim u vërejtën në vitin 2008, me alokimin e një shume prej 400,000 eurosh të destinuara për subvencionim të prodhimit të grurit – shumë kjo e cila në vitin 2016 ka arritur vlerën prej 46 milionë eurosh. Mirëpo, të përballur me një buxhet deficitar i cili nuk arrin të përmbushë të gjitha nevojat në nivel kombëtar, atëherë medoemos ballafaqohemi me sfidën e nevojës së prioritizimit. Ajo çka e bën këtë detyrë ende më të vështirë, është fakti se energjia ashtu edhe bujqësia, janë dëshmuar si dy sektorë me potencial të lartë për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të vendit.

Prandaj, të gjendur përpara një dileme të tillë ku na kërkohet të pozicionohemi për njërin apo tjetrin, vijmë

Saloniet e së martës janë një risinë javore e Institutit Demokraci për Zhvillim (D4D). Salonet ka format gjysmë-formal sipas rregullës Chatham House dhe bëjnë punë të mediave. Diskutimi mbledh rreth vetes ekspertë e analistë politikane e publiciste për të reflektuar dhe kërkuar konsensus mbi temat e përzgjedhura. Fjalat e hapjes postohen në www.youtube.com/user/TuesdaySalon. Secili Salon përçillet me një editorial që publikohet në gazetën Zëri të martën e ardhshme. Podcastet bazuar në editorialet mund të gjenden në d4d-ks.org/salonet-podcast-per

rjen e “përparësisë krahasuese” si kriter përcaktues përvendim tonë se cilin sektor të prioritizojmë. Mirëpo një qasje e tillë duket jo shumë racionale, duke qenë që subvencionet janë realisht vendime politike në veçse të jenë ekonomike. Dizajnimi i skemës së subvencionimit bëhen “pre” e premtimeve elektorale. Prandaj subvencionet jогjithnjë kanë për qëllim përfundim të rritjen e efikasitetit.

Duke e parë që subvencionet janë pöthujse të pashmangshme dhe duke trajtuar mundësinë që të mbyllet detyrohemi të zgjedhim njërin karshi tjetrës, lind idja për skenarin e tretë “edhe-edhe”. Rrjedhimisht fokusohemi drejt identifikimit të pikave të përbashkë ku këto dy sektorë do të mund të takoheshin dhe të zhvillohen krah për krah. Aktualisht në Bashkimin Evropian subvencionet në agrikulturë përbëjnë rreth 40% të buxhetit total. Mirëpo, marrja e subvencioneve kushtëzohet me nevojën për investim në Burime të Ripërtërueshme të Energjisë (BRE). Me këtë rast bujqit do të mundë


deri te ndërtimi i tre skenarëve të cilët medoemos duhet t'i shtjellojmë.

Skenari i parë i ashtuquajtur "as-as", aludon për një zhvillim të të dy sektorëve pa prezencën e subvencioneve. Në një ekonomi ideale, që realisht e hasim vetëm në literaturën ekonomike, përgjigjja në pyetjen fillestare do të ishte "as njëra dhe as tjetra". Duke qenë që, nevoja për prezantimin e subvencioneve apo ndihmave direkte lind në momentin që ne kemi mungesë të efikasiteti në një sektor të caktuar. Në pamundësi për të luftuar problemin në origjinë, atëherë i nënshtrohemi asaj që në ekonomi njihet si "second best" apo alternativa e dytë më e mirë e që në këtë rast janë subvencionet. Për më tepër, subvencionet krijojnë shtrembërime në incentiva dhe rishpërndarje të parave, pasi që në esencë ata mund të jenë edhe diskriminuese. Mirëpo, një skenar i tillë nuk gjen dot aplikim në rrethanat aktuale ekonomike.

Andaj lëvizim të skenari i ashtuquajtur "ose-ose". Në rast të nevojës për qasje të tillë përjashtuese, duhet të sqarojmë se cili është objektivi ynë në rrafshin makroekonomik. Në qoftë se qëllimi ynë është zvogëlimi i papunësisë, atëherë me automatizëm do të fitonte bujqësia. Kjo për shkak se, ndër të tjera krijimi i një vendi të punës në bujqësi ka kosto dukshëm më të ulëta se krijimi i një vendi të punës në energji, që njihet si sektori me koston më të lartë në këtë drejtim. Njëkohësisht, në Kosovë efektet e masave në kuadër të Programit të Zhvillimit Rural në vitet e fundit kanë rezultuar në përmirësim të bilancit tregtar dhe nivelit të prodhimitarisë vendase. Ndikimi në punësim është po ashtu i madh, ku nga viti i kaluar janë krijuar rreth 2,300-2,500 vende të reja të punës si rezultat i këtij investimi.

Mirëpo, nuk mund të mos theksoj që përderisa bujqësia është duke qenë një prej sektorëve më dinamik, i cili mëton të krijojë kushtet për krijimin e zinxhirit të vlerës së shtuar të agroprodukteve, një gjë e tillë mund të bëhet vetëm nëse paralelisht sigurojmë infrastrukturën e plotë energjetike. Rreth 50% të bizneseve në Kosovë e konsiderojnë mungesën e furnizimit të rregullt si pengesë të madhe.

Panelistët e Sallonit të së Martës diskutuan edhe mar-


www.zeri.info/zerat/

<http://www.zeri.info>
/opinione

 like >
facebook.com/gazetazeri

 follow >
twitter.com/gazeta_zeri

shfrytëzimin sipërfaqet e tokave të tyre për të instaluar panele solare. Kjo përveçse do t'u mundësonte të prodnin energji për nevojat e veta, ata do të mundë të shesin sasinë shtesë për konsum të përgjithshëm. Duke qenë Kosova është zotuar të arrijë cakun obligativ prej 25 një bashkëdyzim i tillë do të ishte më se i mirëseardhshëm. Si duket një praktikë e tillë është në ngjizje të sipërme edhe në Kosovë.

Përpara se të tundohej të japim një verdikt firmë duhet sqaruar që subvencionet për prodhim të energjitashmë janë të ndaluara në bazë të politikave të përpiluar nga BE-ja. Kosova i është nënshtuar këtyre obligimeve duke qenë nënshtruar këtyre obligimeve të Energjisë. Thënë ndryshe, lloji i subvencionimit i është bërë Korporatës Energjetike të Kosovë deri tani, tashmë nuk është i pranueshëm. Për më tepër, liberalizimin e tregut nuk lejohet që të ketë masa preferenciale karshi prodhuesve vendorë, për të respektuar kështu parimet thelbësore të tregut të lirë.

Respektivisht, duke pasur një limitim të tillë, ne duhej të përcaktoheshim për kombinim të subvencionimit të bujqësisë me fokus në integrimin e BRE-ve. Vendi të theksohet që subvencionimi për BRE tashmë ekziston në Kosovë, duke qenë që skema e tarifave nxitë të njohura si "Feed-In-tariffs", është një masë në vlerë e subvencionimit. Ajo çka nuk duhet të anashkalohet kurrësesi, është subvencionimi në fushën e eficientë së energjisë, një tjetër fushë ku Kosova është betuar të arrijë cakun prej 9% apo 91ktoe deri në vitin 2020. Mbi të gjitha, një qasje e tillë do ndihmonte në ngritjen e vetëdijesimit të popullatës dhe si përfundim do kishte një efekt të dukshëm në zvogëlimin e konsumit të energjisë elektrike.

Nevoja për përkushtim drejt identifikimit të modelit të liteteve për realizim të tezave të propozuara në skenat e tretë do të duhej dhe të bëhet objektivi i politikave qeveritare. Një qasje e tillë do të mundësonte zhvillim paralel të qëndrueshëm të dy sektorëve dhe njëherë një përmbushje reale të objektivave të parashtruar në rrafshin ekonomik, si dhe në kuadër të proceseve integruese në organizatat ndërkombëtare.